



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-04

Vendos: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 26 maj 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

URDHËR

për caktimin e datës së synuar për një vendim sipas nenit 39(2)

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 85(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Prokurori i Specializuar parashtrroi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, së bashku me materialin provues mbështetës të pretendimeve faktike dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.²
2. Më 28 shkurt 2020, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 18 mars 2020 të parashtronte, ndër të tjera, një aktakuzë të rishikuar.³
3. Më 18 mars 2020, ZPS-ja parashtrroi aktakuzën e rishikuar për konfirmim.⁴
4. Rregulla 85(5) e Rregullores përcakton se gjykatësi i procedurës paraprake parashikon një datë për vendimin e vet sipas nenit 39(2) të Ligjit e cila nuk është më vonë se gjashtë muaj nga parashtrimi i aktakuzës dhe i të gjithë materialit mbështetës.

II. VENDIM

5. Gjykatësi i procedurës paraprake në vijim:

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesa lidhur me të*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-04, F00003, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores*, 28 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00004, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim dhe kërkesa lidhur me të*, 18 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

VENDOS që vendimi sipas nenit 39(2) të Ligjit të lëshohet më 12 qershor 2020.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i procedurës paraprake

E martë, 26 maj 2020

Në Hagë, Holandë.